



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 5259 Prot

Ballsh, më 02.11.2023

VENDIM

Nr. 49 Datë 30/10/2023

“Për miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër, së bashku me dokumentacionin tekniko ligjor, për akordimin e ndihmës financiare **Z Gezim Dajlanaj**, banorë të fshatit Kash, Njësia Administrative Qëndër, Bashkia Mallakastër, banesa (një katë) e cila është dëmtuar si pasojë e rënies së zjarrit më datë 04.10.2023 ”.

Baza ligjore

- Ligji Nr.139/2015 date, 17.12.2015 "Per Veteqeverisjen Vendore".
- Ligji Nr.107/2016 date 27.10.2016 "Per Prefektin e Qarkut".
- Ligji Nr.45, date 18.07.2019 "Per Mbrojtjen Civile".
- V.K.M. nr. 329, datë 16.05.2012 "Për kriteret dhe procedurat dhënies se ndihmës shtetërore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqesit natyrore ose fatkeqësi të tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore”.

VENDOSI

1. Miratimin e kërkesës së Bashkisë Mallakastër për mbështetje financiare të qytetarit **Gëzim Dajlanaj**, banesa e të cilit është dëmtuar si pasojë e zjarrit të rënë më datë 04.10.2023.
2. Miratimin e dokumentacionit tekniko-ligjor të administruar nga ana e Bashkisë Mallakastër.
3. Miratimin e vlerës totale prej **544 200 (pesëqind edyzetekater mijë e dyqind) lekë**. dëme në orendi shtëpiake.
Miratimin e vlerës në masën prej **50 %**, **462 697 (katëqind e gjashtëdhjetë e dy mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e shtatë) lekë**, e vlerës totale prej **925 395 (nëntëqind e njëzetë e pesë mijë e treqind e nëntëdhjetë e pesë) lekë**, dëme nga ana ndërtimore.

Totali i vlerës (nga ana e orendive shtëpiake + 50 % nga ana ndërtimore pa TVSH) është 1 006 897 (njëmiljon e gjashtëmijë e tetëqind e nëntëdhjet e shtatë) leke.

4. Vlera e dëmit është përlogaritur nga Komisioni i Vleresimit të dëmeve, i ndryshuar të Bashkisë Mallakastër, ngritur me Urdhër nr.375 datë 11.12.2018 të Kryetarit të Bashkisë Mallakastër.
5. Bazuar në ligjin 45, datë 18.07.2019 neni 41 "E drejta e kompesimit", pika 2, në të cilën thuhet "Dëmet përballohen nga vetë bashkitë e prekura nga fatkeqësia, nëpërmjet fondit të dedikuar për mbrojtjen civile.
6. Ndihma financiare për familjen e qytetarit Gëzim Dajlanaj përcaktohet sipas kriterëve të VKM-së nr.329, date 16.05.2012 "Per kriteret dhe procedurat dhenies se ndihmes shteterore financiare për mbulimin e dëmeve të shkaktuara nga fatkeqësit natyrore ose fatkeqësitë e tjera të shkaktuara nga veprimtaria njerëzore". Bazuar ne përputhje me çmimet aktuale mesatare të investiguara nga ana e Drejtorisë Rajonale Tatimore Fier "Çmimet e investiguara për mobilje, elektroshtëpiake, çmimet sipas zërave të punës nga ana ndërtimore".

KRYETAR

Nexhmi Sulaj

